



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 245, datë 20.12.2018

PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INTERSIG VIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21) të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 246, pikës 4), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Analiza e gjendjes financiare e shoqërisë “Intersig VIG” sh.a. më 30.09.2018 është kryer mbi bazën e pasqyrave financiare të raportuara nga shoqëria, si dhe mbi bazën e të dhënave shtesë, të kërkuara kësaj shoqërie nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Referuar konkluzioneve të analizës financiare rezulton se shoqëria “Intersig VIG” sh.a. ka raportuar me vonesë në formë shkresore në Autoritet dhe në portal formularin “Llogaritja ditore e normës së likuiditetit” për muajt korrik, gusht dhe shtator 2018. Gjatë tre mujorit të tretë të vitit 2018 shoqëria e ka përmbushur nivelin e kërkuar të normës së kërkuar të likuiditetit ≥ 1 .

Shoqëria “Intersig VIG” sh.a. tejkalon afatin e depozitimit të këtij raporti në Autoritetin, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Autoritetit nr. 56, datë 28.04.2016.

Në bazë të nenit 246, pika 4, të Ligjit 52/2014, për këtë shkelje parashikohet sanksion me gjobë.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në nenin 246, pika 4), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të sanksionohet me gjobë në masën 100,000 lekë, personi përgjegjës i shoqërisë “Intersig VIG” sh.a, për mosraportim në përputhje me kërkesat e nenit 85, pika 1, germa ë) të Ligjit 52/2014 si dhe të Rregullores nr. 56, datë 28.04.2016 “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI